

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2


Lufta kundër Piraterisë online: AMA vendos gjobë 5 milion lekë, bën denoncimin në Prokurori dhe ndjek shkelësin deri në Gjermani e Rumani

Një rast i ri piraterie online është denoncuar nga kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi. Duke iu referuar subjektit të fundit të paligjshëm, të konstatuar, dënua dhe denoncuar nga ekipet,...



Fq. 2

Transpozimi i EMFA-s dhe DSA-së: Me mbështetjen e KiE-së, AMA zhvillon tryezë pune me ekspertin Francesco Sciacchitano të AGCOM



Fq. 2

AMA nis Konsultimin Publik për ndryshimet në Rregulloren e Autorizimeve: Masa të reja mbrojtëse për të drejtën e transmetimit

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka hedhur për konsultim publik ndryshimet e propozuara në rregulloren, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimev..."

Kushtet e punës së gazetarëve, kryetarja e AMA-s dhe kreu i Inspektoriatit të punës bashkëbisedojnë me grupet e interesit

Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kanë organizuar...



Fq. 2



Fq. 3

AMA-RTSH: Bashkëpunim institucional për një media publike moderne dhe në shërbim të qytetarëve

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) mori pjesë në tryezën gjithëpërfshirëse të organizuar nga Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)...

Transpozimi i EMFA-s dhe DSA-së: Me mbështetjen e KiE, AMA zhvillon tryezë pune me ekspertin Francesco Sciacchitano të AGCOM

Transpozimi i dy akteve të reja europiane për median (EMFA) dhe për shërbimet digjitale (DSA) ishin thelbi i tryezës dy ditore të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive me ekspertë të KiE dhe Z. Francesco Sciacchitano nga autoriteti italian AGCOM. Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm në procesin e përafrimit të Shqipërisë me standardet e Bashkimit Europian në fushën e medias dhe shërbimeve digjitale, duke forcuar më tej rolin e AMA-s si institucion kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe funksionimin e një hapësire mediatike të lirë, të sigurt dhe gjithëpërfshirëse. [Lexo më shumë](#)



Lufta kundër Piraterisë online: AMA vendos gjobë 5 milion lekë, bën denoncimin në Prokurori dhe ndjek shkelësin deri në Gjermani e Ruman

Një rast i ri piraterie online është denoncuar nga kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi. Duke iu referuar subjektit të fundit të paligjshëm, të konstatuar, dënuar dhe denoncuar nga ekipet e inspektimit të Autoritetit, Krasniqi ka treguar historikun e gjurmimit dhe bllokimit të një rasti të kapur fillimisht në Kukës, si transmetues i paligjshëm IPTV, e me tej i transferuar në servera të tjerë nëpër Europë. Ndërkaq po në Kukës janë ndëshkuar me gjobë dy operatorë piratë dhe një tjetër në Golem. [Lexo më shumë](#)



AMA nis Konsultimin Publik për ndryshimet në Rregulloren e Autorizimeve: Masa të reja mbrojtëse për të drejtën e transmetimit

Autoriteti i Mediave Audiovizive ka hedhur për konsultim publik ndryshimet e propozuara në rregulloren, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve". Për këtë qëllim, kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ka nisur turin e takimeve me operatorët audiovizivë në Kukës, Dibër, Elbasan, Durrës, Tiranë, Shkodër, Lezhë, Berat, Pogradec si dhe me përfaqësuesit ligjorë të Digicom, Digitalb, Vodafone, ONE Albania dhe Tring.

[Lexo më shumë](#)

Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kanë organizuar një tryezë...



Autoriteti i Mediave Audiovizive në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore kanë organizuar një tryezë bashkëbisedimi, mbi kushtet aktuale të punës dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, profesional, të drejtë dhe dinjitoz për të gjithë punonjësit e medias audiovizive. Kjo tryezë është organizuar si aktiviteti i parë, i parashikuar në planin e punës, të miratuar nga të dy institucionet, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes AMA-s dhe Inspektoratit të Punës.

[Lexo më shumë](#)



AMA-RTSH: Bashkëpunim institucional për një media publike moderne dhe në shërbim të qytetarëve

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) mori pjesë në tryezën gjithëpërfshirëse të organizuar nga Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), me temë "RTSH - Sfidat e sotme dhe vizioni për të ardhmen". Kryetarja e Autoritetit, Znj. Armela Krasniqi, theksoi se marrëdhënia ndërmjet AMA-s dhe RTSH-së është një raport i përcaktuar ligjrisht, i cili përkufizon qartë përgjegjësitë dhe pritshmëritë nga të dy institucionet.

[Lexo më shumë](#)